



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

Nr.4917/2 Prot.

Datë 26.05.2023

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.35, datë 26.05.2023

(Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”)

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 43 dhe 46 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, ligjit nr. 7895 datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.7905 datë 27.04.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.02 dt.12.05.2023 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;

KONSTATOJ:

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.226, datë 13.04.2023 ka miratuar rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, të cilat i'a ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm.

Mbi bazën e këtij vendimi, nga ana e PP është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 si dhe Urdhëri nr.70, datë 12.05.2023, të cilat së bashku me Rekomandimet Prioritare të KM për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, i janë shpërndarë për njohje trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie.

Më datë 25.05.2023, në zbatim të thirrjes nr.34, datë 22.05.2023, është organizuar mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Me qëllim forcimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është e nevojshëm të miratohet një udhëzim i përgjithshëm në funksion të unifikimit të ndjekjes penale efektive dhe zbatimit të një politike penale unitare, pa cënuar pavarësinë substanciale dhe funksionale të prokurorëve në hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.

Sa më sipër me qëllim ushtrimin e funksionit të Drejtuesit të Prokurorisë ;

UDHËZOJ :

1. Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndjekin me diligjencë zbatimin dhe vlerësojnë masat e nevojshme për të mundësuar përmbushjen e rekomandimeve prioritare për zbatimin e politikës në luftë kundër krimit sipas drejtimeve të rekomanduara dhe për veprat penale prioritare të rekomanduara, në përputhje me përcaktimet e dhëna në VKM nr.226/2023.
2. Drejtuesi i Prokurorisë miraton një plan veprimi për përmbushjen e rekomandimeve prioritare në luftë ndaj kriminalitetit për vitin 2023 të dhëna në VKM nr.226, datë 13.04.2023 si dhe një plan veprimi për ndjekjen e rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të RSH për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë.

3. Drejtuesi i Prokurorisë nxjerr, konform ligjit, udhëzime jo të detyrueshme për çështje penale konkrete për rastet e hetimit të veprave penale prioritare dhe/ose ndaj subjekteve të rekomanduara.
4. Drejtuesi i Prokurorisë merr të gjitha masat e nevojshme procedurale dhe administrative për të mundësuar zbatimin rekomandimeve prioritare në përputhje me treguesit e gjendjes së kriminalitetit dhe specifikat e çështjeve penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
5. Prokurorët vlerësojnë në çdo rast masat që duhet të marrin në zbatimin e rekomandimeve prioritare, duke treguar diligjencës e duhur në ushtrimin efektiv të ndjekjes penale dhe duke ruajtur pavarësinë e tyre funksionale nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimarrjen e tyre.
6. Prokurorët e kësaj prokurorie fokusohen në kryerjen e hetimeve të gjithanëshme për veprat penale dhe ndaj subjekteve prioritare të rekomanduara, duhet të rrisin kujdesin e nevojshëm për hetime pro-aktive, të konsiderojnë fillimin e hetimeve penale kryesisht, respektojnë të drejtat e palëve në proces si dhe garantojnë procesin e rregullt ligjor si dhe zbatojnë një politikë penale sipas rekomandimeve të dhëna.
7. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie kujdesen për të garantuar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në proces penal si dhe për të ndërtuar një ndjekje penale efektive ndaj krimit të organizuar, korrupsionit si dhe ndaj veprave penale dhe subjekteve prioritare të rekomanduara.
8. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie kujdesen për të garantuar pavarësinë në vendimarrjen e tyre nga çdo ndërhyrje e paligjshme, duke siguruar zbatimin e kërkesave të ligjit si dhe duke reaguar proceduralisht në rastet e konstatimit të ndërhyrjeve të paligjshme.
9. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë diligjencën e duhur për të pasur një bashkëpunim korrekt dhe në kohë reale me strukturën e posaçme SPAK për fakte që vihen në dijeni të cilat përfshihen brenda sferës së veprimit dhe kompetencës hetimore të kësaj strukture.
10. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë diligjencën e duhur për të iniciuar kryesisht dhe rritur numrin e hetimeve pasurore përsa i takon hetimit dhe gjurmimit të pasurive të dyshuara me

burim kriminal, për plotësimin e rekomandimeve të Moneyval, duke utilizuar edhe bashkëpunimin rajonal si dhe me Eurojust.

11. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë marrjen e masave të nevojshme procedurale për të siguruar rritjen e gjykimeve të posaçme, të tilla si gjykimet me marrëveshje dhe aplikimin e urdhërave penale si dhe të gjykimeve të drejtpërdrejta.
12. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave të shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit në konflikt me ligjin si dhe të masave alternative të dënimit penal me burg.
13. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përsa i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale, krimet e rënda, trafiket e paligjshme, krimet mjedisore, abuzimet me të mitur, krimeve kibernetike dhe veprat e tjera penale të rekomanduara.
14. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale, forcimin e dilijencës në hetime dhe rritjen e vëmëndjes në hetimin dhe gjykimin e efektiv të krimeve zgjedhore, rrisin bashkëpunimin e shërbimet e policisë gjyqësore në institucione të tjera.
15. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave ndaj pasurisë me burim kriminal sipas kriterëve të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.10192/2009 si dhe rrisin kujdesin e nevojshëm për ndjekje penale efektive të rasteve të pastrimit të produkteve të veprës penale.
16. Drejtuesi i Prokurorisë merr masa për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve CAMS dhe sistemin PRESTO.
17. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie marrin masat e nevojshme për të forcuar kontrollin dhe drejtimin ndaj policisë gjyqësore në hetimin e çështjeve penale si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për oficerët e policisë gjyqësore që me veprimtarinë e tyre sjellin pasoja në ndjekjen penale.
18. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme për të koordinuar punën hetimore me institucionet e tjera që kanë në varësi struktura që ushtrojnë atributet e policisë gjyqësore, vëçanërisht me policinë e shtetit, strukturat e hetimit tatimor, doganor etj.
19. Drejtuesi i Prokurorisë vlerëson ngritjen dhe krijimin e grupeve hetimore për çështje penale dhe hetimeve komplekse.

20. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin, sipas ligjit, udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të rekomandimeve prioritare për ndjekjen penale efektive ndaj kriminalitetit për vitin 2023.
21. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin me diligjencë dhe në afat plotësimin e kërkesave nga autoritetet e huaja për ndihmë juridike në fushën penale.
22. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme administrative për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
23. Zv. Drejtuesi i Prokurorisë dhe Kancelarja janë përgjegjës për raportimin periodik dhe sa herë kërkohet në PP për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftë ndaj kriminalitetit.
24. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Një kopje e këtij udhëzimi i 'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.
25. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për publikim në zbatim të nenit 46/5 të ligjit nr.97/2016.
26. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

KRESHNIK AJAZI

